

VENDIM
Nr. 304, datë 29.4.2026

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 297, DATË 20.4.2016,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KALIMIN NË PRONËSI, NGA
DREJTORIA E SHËRBIMEVE QEVERTARE TEK BASHKIA SARANDË, TË
PRONËS ME EMËRTIMIN “REZIDENCË QEVERTARE”, ME VENDNDODHJE
NË ZONËN KADASTRALE 8642, SARANDË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË
VENDIMIN NR. 1058, DATË 16.7.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, PËR DREJTORINË E SHËRBIMEVE
QEVERTARE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 7, 8 e 12, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 297, datë 20.4.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin në pronësi, nga Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare tek Bashkia Sarandë, të pronës me emërtimin ‘Rezidencë qeveritare’, me vendndodhje në zonën kadastrale 8642, Sarandë, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 1058, datë 16.7.2008, të Këshillit të Ministrave, ‘Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Këshillit të Ministrave, për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare’”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në pikën 1, pas fjalëve “... dhe ndërtimin e një Eko-Kampusi” shtohen fjalët “... si dhe për zhvillimin e projektit “Poli i Zhvillimit Turistik Sarandë”;;

b) Në pikën 3 hiqen fjalët “... ta tjetërsojë atë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.”.

2. Ngarkohen Bashkia Sarandë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçiu